

## VENDIM

Nr. 796, datë 24.12.1998

### **PËR TË ARDHURAT E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË (QKK), PËR SHPËRBLIMET E KËSHILLAVE MIRATUESE TË PROJEKTEVE, TË KOMISIONIT TË VIZIONIMIT DHE TË KOMISIONIT FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

##### **A. Të ardhurat jobuxhetore të QKK-së sigurohen si më poshtë:**

- 1) 20 për qind e të ardhurave të filmit, që janë rezultat i subvencionit me fonde të QKK-së, i takojnë QKK-së. Pjesa tjetër i mbetet producentit.
- 2) 50 për qind e të ardhurave, që realizohen nga shitja dhe qarkullimi i veprave filmike, të prodhuara deri më 1.6.1997 me fonde buxhetore ose pjesërisht buxhetore. Pjesa tjetër i mbetet “Albafilm” Studios.
- 3) 1 për qind i shitjes së çmimit të biletave të sallave të shfaqjes së filmit.
4. Tarifat e regjistrimit të producentëve, distributorëve, si dhe ato për kategorizimin dhe licencimin e filmave caktohen nga QKK-ja, çdo vit.

##### **B. Pagesat (shpërblimet) e këshillave miratues të projekteve, komisionit financiar dhe komisionit të vizionimit janë:**

###### **1) Pagesat (shpërblimet) e këshillave miratues të projekteve:**

- 10 000 (dhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit artistik.
- 4 000 (katër mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit dokumentar.
- 2 000 (dy mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit vizatimor.

###### **2) Shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar:**

- 10 000 (dhjetë mijë lekë) për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit artistik.
- 4 000 (katër mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit dokumentar.
- 2 000 (dy mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit vizatimor.

###### **3) Shpërblimet e anëtarëve të komisionit të vizionimit:**

- 500 (pesëqind) lekë, kur filmi vizionohet në sallë.
- 200 (dyqind) lekë, kur filmi vizionohet në video.

Kryetarët e këshillave miratuese të projekteve, të komisionit të vizionimit dhe të komisionit financiar paguhen 20 për qind më shumë se anëtarët e tjerë.

4) Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë që nga data e krijimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**